



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec  
Opština Skupština Rahovaç/Municipality of Rahovec  
RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/256 Nr. i faq/Br.str/No.pg 70

Data/Datum/Date 29/10/2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore 2022 – 2026, Programit të Kosovës për Barazi Gjimore 2024 – 2026, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.10.2024, miraton këtë:

### V E N D I M

#### Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore 2024 - 2026

1. Me këtë vendim **miratohet** Plani Lokal i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore 2024 - 2026 në Komunën e Rahovecit.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Lokal i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore 2024 – 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët/eshat e drejtorive.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorëve/eshave të drejtorive,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.256/24  
Datë:29.10.2024

Arbër Zenuni  
Kryesues i Kuvendit